



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITAN	
02 Nr. / Dr.	290/20
Nr. / Fq. / Dës.	-02-
Data: / Datum	12.03.2020
VUSHTRRI - VUČITAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 12 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-Nr. 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/07, me rekomandim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në mbledhjen e mbajtur me datë 12.03.2020 lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Komunën e Vushtrisë, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërmarrjen e masave preventive për mbrojtje nga korona virusi si në vijim:

1. Të formohet Shtabi Komunal ndër sektorial për koordinim të aktiviteteve preventive për parandalim të COVID 19. Drejtori i Shëndetësisë do të jetë në krye të këtij Shtabi. Pjesë e Shtabit janë: Policia e Kosovës, Drejtoria e Emergjencave, Shërbimeve Publike, Inspektorati Komunal, Arsimi, Përfaqësues i Bizneseve, Përfaqësues i BIK, OJQ, përfaqësues i Spitalit "Sheik Zayed",
2. I gjithë stafi i Kujdesit Primar Shëndetësor si dhe institucionet e kujdesit primar shëndetësor të jenë në gjendje gatishmërie, të ndërpriten pushimet e stafit si dhe të krijohet lista e personelit mjekësor jashtë QKMF-së në rast nevojë,
3. Të dezinfektohen të gjitha institucionet publike komunale menjëherë,
4. Të bëhet dezinfektimi i të gjitha lokaleve e bizneseve në Komunë (me urgjencë Qebaporet, çajtoret, restorantet dhe kafiteritë). Inspektorati i Komunës do të inspektojë të gjitha bizneset dhe do të marrë masa adekuate ligjore kundër secilit që shmang dezinfektimin e lokalit,
5. Kërkojmë nga bizneset që të mos bëjnë ngritjen e çmimeve duke shfrytëzuar situatën e krijuar me koronavirusin. Inspektorati komunal do të monitorojë dhe do të reagojë me masa ligjore ndaj subjekteve afariste që manipulojnë me çmime të produkteve,
6. Institucionet fetare do të kryejnë shërbimet fetare me kohë të reduktuar; të bëhet dezinfektimi i objekteve fetare po ashtu,

7. Komuna e Vushtrrisë inkurajon qytetarët që në komunikim të drejtpërdrejt me komunën të shfrytëzojnë linjën telefonike në Qendrën e thirrjeve të Komunës së Vushtrrisë në numrin pa pagesë 0800 42000 për shërbimet që ata duan të marrin nga komuna,
8. Aty do ti marrin informatat e hollësishme për shërbimet që mund ti kryejnë,
9. Shërbimi në qendrën e thirrjeve është në dispozicion për qytetarë çdo ditë të javës, nga e hëna deri të premten, prej orës 08:00 deri 16:00,
10. Komuna pezullon shërbimin me palë në drejtoritë tjera me përjashtim të rasteve emergjente,
11. Të gjitha shërbimet e gjendjes civile dhe shërbimet tjera do të kryhen në sportelet në Qendrën e Shërbimit të Qytetarëve katin përdhes të Komunës ndërsa të punësuarit do të pajisen me mjete mbrojtëse,
12. Shërbimi i Zjarrfikësve të jetë në gjendje gatishmërie të plotë,
13. Të anulohen konkurset publike për punësim në organet komunale,
14. Urdhërohen bizneset që në hyrje të lokaleve të vendosin dezinfektues,
15. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit,
16. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të komunës.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës